



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1567/ 2 prot

Datë 06.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitur nga operatorët ekonomikë “*Primus Albania*” SHPK dhe “*Kreatx*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-67579-04-27-2023, me objekt “*Mirembajtje e Customer Relationship Management (CRM) dhe sistemit te Faturimit per OSHEE*”, me fond limit 119.770.498 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatë dhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) leke, pa TVSH ose 1,078,721.95 (një milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e një pikë nëntëdhjetë e pesë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 27.04.2023 1 euro = 111.03 All, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
- Ankimues:** Bashkimi operatorëve ekonomikë “*Fluentgrid Limited*” & “*BNT Electronics*” SHPK
Adresa: Blv “Zhan D'ark”, Nd. 32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”, Nd. 88, H.1, 1023, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*Primus Albania*” SHPK
Adresa: Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati Viridario 1, Tiranë.
- Operatori ekonomik “*Kreatx*” SHPK
Adresa: Rruga “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë.

Në datën 05.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1567 prot, datë 05.07.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Fluentgrid Limited*” & “*BNT Electronics*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-67579-04-27-2023, me objekt “*Mirembajtje e Customer Relationship Management (CRM) dhe sistemit te Faturimit per OSHEE*”, me fond limit 119.770.498 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatë dhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) leke, pa TVSH ose 1,078,721.95 (një milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e një pikë nëntëdhjetë e pesë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 27.04.2023 1 euro = 111.03 AL, zhvilluar në datën 29.05.2023 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “*Primus Albania*” SHPK dhe “*Kreatex*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “*Fluentgrid Limited*” & “*BNT Electronics*” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “*Primus Albania*” SHPK dhe “*Kreatex*” SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht Operatori ekonomik “*Primus Albania*” SHPK nuk përmbush:

Kapacitetin ekonomik dhe financiar pikën 2.2.2

2.2.2. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Kapacitetin teknik pikën 2.3.1

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 47,900,000 (dyzet e shtate milion e nentëqind mije) leke pa TVSH.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Kapacitetin teknik pikën 2.3.2

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO), për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe sigurinë mbi informacionin. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Çertifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit të perkthyer dhe të noterizuara:

- ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.*
- Çertifikatën për menaxhimin e informacionit ISO 27001 ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.*
- Çertifikatën për menaxhimin e shërbimeve ISO 20000-1 ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.*

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrin përsipër të realizojnë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kapacitetin teknik pikën 2.3.4

2.3.4 Gjithashtu, mbështetur në kërkesat e specifikimeve teknike dhe teknologjinë hardëare dhe softëare të sistemit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin e nevojshëm IT, punonjës të kualifikuar me një nga kualifikimet e mëposhtme, minimalisht:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim softëare (Oracle Java Certificate ose ekuivalente).
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e serverave në RHEL Linux ose ekuivalent.
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim të serverave Ëindoës ose ekuivalente.
- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për teknologjinë Ëmëare ose ekuivalente.

SHENIM: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Ndersa operatori i kualifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat përkatëse të kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet të vertetojë se i ka të punësuar për periudhën prill 2023.

Si përmbledhje, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatat/diploma përkatëse të kualifikimit për secilin nga specialistet e mesiperm;
- Kontrata të lidhura me stafin e nevojshëm dhe CV;
- Listepagesat e punonjësve dorëzuara nëpërmjet formës elektronike në organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, për muajin prill 2023;

Konkretisht Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK nuk përmbush:

Kapacitetin teknik pikën 2.3.1

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 47,900,000 (dyzet e shtate milion e nentëqind mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kapacitetin teknik pikën 2.3.2

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO), për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe sigurinë mbi informacionin. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Certifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit të perkthyer dhe të noterizuara:

- **ISO 9001** për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.
- Certifikatën për menaxhimin e informacionit **ISO 27001** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.
- Certifikatën për menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kapacitetin teknik pikën 2.3.4

2.3.4 Gjithashtu, mbështetur në kërkesat e specifikimeve teknike dhe teknologjinë hardëare dhe softëare të sistemit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin e nevojshëm IT, punonjës të kualifikuar me një nga kualifikimet e mëposhtme, minimalisht:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim softëare (Oracle Java Certificate ose ekuivalente).
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e serverave në RHEL Linux ose ekuivalent.

- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim të serverave Ëindoës ose ekuivalente.
- 1 (një) punonës te certifikuar ne nivel professional per teknologjinë Ëmëare ose ekuivalente.

SHENIM: Një punonjës mund të ketë një ose disa çertifikime.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Ndersa operatori i kualifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen prill 2023.

Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- Certifikatat/diploma perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;
- Kontrata të lidhura me stafin e nevojshëm dhe CV;
- Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, per muajin prill 2023;

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 06.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri